



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 27 prill 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Mufera Şinik, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Zhivković!

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lavdim Krasniqi dhe Lumnije Krasniqi – KJI, Agron Vrenezi – OHCHR, Luljete Plakolli – Këshilli i Evropës, Isuf Zejna – KDI, Floriana Shala – OSBE dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.3.2011,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010,
4. Shqyrtimi i draft-rregullave për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,
5. Shqyrtimi i propozimit të grupit të punës lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30. 3. 2011

Kryetari konstatoi se pa vërejtje Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30. 3. 2011.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010

Kryetari- I përshëndeti të pranishmit dhe e ftoi z. Lavdim Krasniqin ta paraqet arsyetimin e raportit.

Lavdim Krasniqi- E njoftoi Komisionin për punën e institutit duke shtuar se raporti është pasqyrim i aktiviteteve dhe të arriturat për vitin 2010. Kryesisht përqendrimi i institutit gjyqësor për vitin 2010 ka qenë në ngritjen e kapaciteteve në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe përgjithësisht i sistemit të drejtësisë. Ai tha se në vitin 2010 janë përfshirë të gjitha programet, ashtu siç parashihet në ligjin për themelimin e Institutit Gjyqësor. Është përfshirë programi fillestar për arsimim ligjor, programi për avancim, programi për trajnim dhe programi për hulumtime kryesisht në vitin 2010. Janë realizuar edhe aktivitete në të gjitha këto programe. Në kuadër të këtij programi janë realizuar rreth 100 trajnime. Lidhur me programin tha se është program i ri që ka filluar të zbatohet pas procesit të themelimit dhe riemërimit. Janë realizuar rreth 20 aktivitete trajnuese në disa module, ndërsa kryesisht fokusi ka qenë në përgatitjen e kandidateve për gjyqtarë dhe prokurorë. Janë realizuar rreth 334 sesione trajnuese gjatë këtij viti, programi i vazhdueshëm fokusohet në të gjitha fushat e së drejtës civile penale, penale për të mitur, kundërvajtje, liri dhe të drejta të njeriut. Kryesisht këto janë fushat, trajnimet numrin më të madh e marrin fushat penale dhe civile. Në vazhdim përmendi bashkëpunimin që kanë me institucione të trajnimit në rajon dhe me gjerë. Trajnimet kryesisht janë zhvilluar në Akademinë Gjyqësore të Turqisë. Ai paraqiti edhe detaje të tjera, të cilat janë pjesë e raportit duke dhënë sqarime për pjesët e tij.

Kryetari- Në fjalën e tij tha se raporti më shumë është një raport ilustrues me fotografi, të cilit i mungon pjesa kryesore, pjesa analitike, i mungon identifikimi i problemeve, pjesa krahasuese mes punës që është bërë gjatë vitit 2010 dhe punës që është bërë gjatë vitit 2009. Po ashtu raportit i mungojnë edhe disa elemente të tjera që do të duhet të ishin si konkluzione të raportit. Ishte i mendimit që pjesa me fotografi duhet të hiqet dhe nuk duhet të jenë pjesë e një raporti që i drejtohet Kuvendit, për ne është me rëndësi ana përmbajtësore, se sa ka pasur sukses në aspektin e arritjes së objektivave.

Haki Demolli- U pajtua me parafolësin se raporti vërtet ka shumë fotografi, shumë sllajde, përmban edhe disa pjesë, të cilat nuk do të duhej të jenë pjesë e raportit që i dërgohet Kuvendit. Ai duke ju referuar aktiviteteve trajnuese pyeti se a ka IGJK-ja ndonjë mekanizëm matës për suksesin e trajnimeve, se sa ka ngritje në kapacitetet për punën e tyre? Si dhe cili është mekanizmi në bazë të të cilit përzgjidhen temat me të cilat ushtrohen përfituesit e trajnimeve? A ka ndonjë pyetësor në mënyrë që të dihet se cilat janë nevojat e tyre për trajnim?

Arsim Bajrami- Ishte i mendimit që raporti duhet të spastrohet nga disa detaje administrative, organizative dhe protokollare. Ai shtoi se instituti gjyqësor ka pasur një rol në arsimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pyeti se a ka instituti ndonjë vizion për të ardhmen e tij në mënyrë që të mos vazhdojë me një rutinë që të përsëriten të njëjtat programe dhe a ka ndonjë vizion për ta rritur autoritetin? Ishte i mendimit që pjesë e këtyre programeve duhet ta kenë edhe të drejtën administrative.

Ibrahim Makolli- Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve tha se ka pas një avancim në krahasim me vitin e kaluar. Ndërsa sa i përket fotografive u pajtua që ato duhet të hiqen, kurse lidhur me atë që u tha se mungojnë krahasimet, ai sqaroi se Kuvendi nuk i ka lejuar që të ketë një krahasim mes raporteve. Ishte i mendimit se do të duhej të ekzistojë një rregullore për institucionet që i raportojnë Kuvendit, që të precizohet se çka duhet të përmbajë raporti, prandaj edhe kemi këso forma të ndryshme të raporteve, varësisht se çka e kërkon secili Komision.

Albulena Haxhiu – E vlerësoj që ka pasur një përparim, sa i përket viteve të mëparshme. Ajo kërkoi sqarim lidhur me atë se janë rritur trajnimet e organizuara paralelisht me zvogëlimin e buxhetit. Pyeti, a ka ndodhur ndonjëherë që një kandidat të kalojë provimin, mirëpo të mos emërohet nga presidenti?

Armend Zemaj- E vlerësoi raportin duke shtuar se bashkëpunimi nuk ka munguar mes institutit dhe Kuvendit edhe në aspektin e avancimit të Institutit Gjyqësor Kosovës. Në vazhdim tha se kemi biseduar për ndryshimin e ligjit në atë kohë, pyeti a keni qenë të kyçur ju për amandamentimin e ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor? Cili është roli juaj në avancimin e Institutit Gjyqësor?

Halit Krasniqi- U pajtua me sugjerimet e parafolësve dhe e vlerësoi angazhimin e institutit lidhur me punën e tij.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj Lavdim Krasniqi duke dhënë sqarime për secilën nga pyetet e adresuara.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, e nxori këtë*

PËRFUNDIM

Komisioni e mbështeti raportin dhe vlerësoi që Instituti Gjyqësor të sjellë raportin e rishikuar para se të përcillet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare.

4. Shqyrtimi i draft-rregullave për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

Kryetari e ftoi z. Arsim Bajramin që ta njoftojë Komisionin për punën e grupit të punës, i ngarkuar për hartimin e rregullave për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.

Arsimi Bajrami- E paraqiti draftin e rregullave të përgatitura nga grupi punës dhe e njoftoi Komisionin me punën e tij. Rregullorja është detajizuar lidhur me procedurat e emërimit dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe propozoi që të miratohet nga Komisioni dhe ta përcjellin për Kuvend.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, e nxori këtë*

PËRFUNDIM

Komisioni e miratoi rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij dhe vendosi t’ia procedojë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

5. Shqyrtimi i propozimit të grupit të punës lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese

Shqyrtimi i propozimit të grupit të punës lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese nuk u shqyrtua për shkak se para shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryesuesi i grupit të punës, z. Haki Demoll, nuk ishte i pranishëm për ta informuar Komisionin për punën e këtij grupi. Andaj Komisioni vendosi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

6. Të ndryshme

Armend Zemaj- Raportoi për punën e Nënkomisionit për mandate imunitete dhe rregullore. Ai tha se kemi filluar të punojmë ne draftimin e rregullores së re dhe kemi arritur t'i kalojmë diku rreth 9 amendamente. Jemi në punë intensive dhe mendojmë që në afatin e përcaktuar do ta përfundojmë. Me datën 6 dhe 7 do jemi dy ditë pune në një workshop dhe besoj që do ta kemi një draft final që do t'i paraqesim Komisionit për votim ose për miratim.

Arsim Bajrami- E informoi Komisionin se grupi parlamentar i PDK- së ka bërë caktimin e zëvendëskryetarit, i cili është caktuar Behar Selimi. Ai, po ashtu, e informoi Komisionin se Komisioni për amendamentimin e Kushtetutës, të premten në orën 11:00 do ta mbajë mbledhjen konstituive dhe do të kërkoja që të autorizohet stafi i këtij komisioni të asistojë në këtë mbledhje deri sa të caktohet një staf i përhershëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi